

VENDIM
Nr. 160, datë 26.11.2012

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË KESH SHA DHE “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË
LIDHJE ME VENDIMIN NR. 134, DATË 17.9.2012 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA/FPSH DHE
SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA/FPP PËR PERIUDHËN 1.1.2012 - 31.12.2014**

Në mbështetje të neneve 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2011, pasi u njoh me ankesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” sh.a., mbi vendimin nr. 134, datë 17.9.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s mbi kontratën për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 deri më 31.12.2014, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për sa i përket propozimit të parashikimit të një reference të saktë për rastet kur kjo shoqëri nuk ka bërë import. Si rrjedhojë, pika 8.3.ii e kontratës, riformulohet:

“Në rastin e importit të një sasive më të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, “CEZ Shpërndarje” do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a., deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, “CEZ Shpërndarje” sh.a. është i detyruar të kompensojë KESH sh.a., në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuara nga KESH sh.a., për sigurimin e kësaj sasive të energjisë elektrike. Në mungesë të importit të energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a., për muajin përkatës, kompensimi do të bëhet me vlerën monetare që i korrespondon çmimit të importit vjetor të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”.

2. Të rrëzojë pjesën tjetër të kërkesës së KESH sh.a., si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në datën 17.9.2012.

3. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për sa i përket propozimit të parashikimit të së drejtës së kësaj shoqërie që të blejë gjithë energjinë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë me çmim të rregulluar. Si rrjedhojë, pika 8.2 e kontratës riformulohet:

“Çdo sasi energjie elektrike e livruar për furnizim të konsumatorëve tariforë, më tepër nga ajo e planifikuar nga ana e palës pranuese, duhet t’i paguhet palës livruese me çmim të rregulluar”.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani